

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2023**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2023

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
6-prill-23		27.54			37.16
13-prill-23		31.91			41.53
20-prill-23		31.12			40.74
24-prill-23			4.41		43.56
27-prill-23		28.36			40.80
3-maj-23		31.63			44.07
11-maj-23		30.88			43.32
18-maj-23		30.22			42.67
24-maj-23			4.42		44.53
25-maj-23		41.17			55.43
1-qershor-23		32.07			46.38
8-qershor-23		29.87			44.18
15-qershor-23		36.14			50.45
22-qershor-23		43.55			57.86
26-qershor-23			7.09		59.47
29-qershor-23		40.41			56.33

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë është rritur në 45.41 miliardë lekë, kundrejt 34.89 miliardë lekësh në tremujorin e mëparshëm. Mungesa


¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti

është kthyer në vlera mbi mesataren e vitit 2022 dhe është stabilizuar në fund të periudhës rreth nivelit 56 miliardë lekë, kundrejt 36 miliardë lekë në fillim të periudhës.

Faktori kryesor i rritjes së mungesës ka qenë akumulimi i likuiditetit në llogarinë e qeverisë për rreth 32.7 miliardë lekë, 5.7 miliardë prej të cilave janë përdorur për të ulur shumën e marrëveshjeve SWAP me Bankën e Shqipërisë, si dhe efekti negativ i rritjes së parasë në qarkullim për 6.1 miliardë lekë me përqendrim në muajin qershor.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, për mesatarisht 32.70 miliardë lekë ose 68%, kundrejt 64% në tremujorin e mëparshëm. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të injektimeve të gjata nga 9.6 miliardë lekësh në fillim të tremujorit në 15.9 miliardë lekë në fund të tij, pesha e injektimeve të gjata nuk është rritur, pasi akumulimi i likuiditetit në llogaritë e qeverisë ka qenë më i shpejtë se vlerësimet tona.

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2023 (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH për shumën maksimale 17.70 miliardë lekë në fillim të periudhës. Në dy muajt e fundit të periudhës, përdorimi i depozitës ka qenë maksimalisht për shumën 8 miliardë lekë dhe në javën e fundit të muajit qershor, me fillimin e RD të re, bankat nuk kanë përdorur këtë instrument.


Rastet e përdorimit të kredisë njëditore kanë rënë gjatë këtij tremujori në 13 prej 20 në tremujorin e kaluar dhe shuma mesatare ka rënë në 0.86 miliardë lekë prej 2.1 miliardë lekësh.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit dytë të vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar të tentojë rritjen e portofolit nëpërmjet ankandeve të blerjes së letrave me vlerë, por pjesëmarrja e bankave ka qenë mjaft e ulët, duke bërë që portofoli të mbetet në vlera pranë nivelit të poshtëm të bandës së miratuar. Krahas hezitimit të zakonshëm të bankave për të marrë pjesë në këto ankande për shkak të ecurisë pozitive të titujve të qeverisë, riklasifikimi i pjesës më të madhe të portofoleve në HTM gjatë vitit 2022 ka qenë një arsye tjetër e pjesëmarrjes së ulët të bankave gjatë vitit 2023.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë është në nivelin më të lartë prej vitit 2009, por në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është rreth 9.3%, kundrejt rreth 25% në fillim të viteve 2000.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës janë zhvilluar operacione rregulluese në fund të RD në muajin maj dhe në qershor. Bankat pjesëmarrëse kanë qenë dy në muajin maj, ndërsa në muajin qershor pjesëmarrëse ka qenë vetëm 1 bankë.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2023, sikurse lajmëruar në 13 dhjetor 2022, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar 6 ankande për blerjen e valutës, dy prej të cilëve kanë qenë me opsionin *forward*.

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2023

Data	Shuma Raundi I (në euro)
1 17/02/2023	5-9 mln (1 mo FW)
2 17/03/2023	5-9 mln (1 mo FW)
3 11/04/2023	5-9 mln (1 mo FW)
4 20/04/2023	5-9 mln
5 11/05/2023	5-9 mln
6 26/05/2023	5-9 mln
7 09/06/2023	5-9 mln
8 21/06/2023	5-9 mln (1 mo FW)
9 06/07/2023	5-9 mln
10 20/07/2023	5-9 mln
11 04/08/2023	5-9 mln

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023

12	18/08/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
13	18/10/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
14	17/11/2023	5-9 mln	(1 mo FW)
15	06/12/2023	5-9 mln	
16	20/12/2023	5-9 mln	(1 mo FW)

Gjatë vitit 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 160-220 milionë Euro.

Pjesëmarrja e bankave ka qenë mjaft e lartë dhe shumat e blera në cdo ankand ka qenë mbi 14 mln euro në të gjithë ankandet me përjashtim të atij të muajit prill ku blenë vetëm 9.10 mln euro dhe mungoi oferta në raundin e dytë. Përfshirë ankandet e muajit korrik, shuma totale e blerë në 10 ankande gjatë vitit 2023 është 150.20 milionë euro dhe kanë mbetur edhe 6 ankande për t'u zhvilluar².

Në fillim të muajit qershor, duke vënë re shpejtësinë e rritur të kursit të këmbimit deri në 4-6% kundrejt dy dhe 3 javëve më parë si dhe mungesën e kërkesave të valutës edhe pas ankandit të Bankës së Shqipërisë së datës 7 qershor, BSH-ja ka vendosur të ndërhyjë në tregun valutor me objektiv shmangien e çrregullimeve, duke blerë 5 mln euro nga bankat e nivelit të dytë³.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, MFE-ja ka maturuar marrëveshjen SWAP për 5.7 miliardë lekë pas maturimit për 8.94 miliardë lekë në tremujorin e parë. Marrëveshjet SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 50 mln euro në 18 shtator 2023
2. 40 mln euro në 20 tetor 2023
3. 45 mln euro në 17 nëntor 2023

Gjatë tremujorit janë blerë 4.47 milionë euro nga programi IPA dhe i janë shitur ASD-së 400 mijë euro.

² Në muajin gusht është ndryshuar kalendari i blerjeve për periudhën shtator-dhjetor, duke shtuar një ankand, dhe është rritur shuma e synuar e blerjeve.

³ Në muajin korrik ka pasur një ndërhyrje tjetër me këtë objektiv.